

MNN QENDRORE

MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

5 nëntor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN

Kolumbia u Bashkua në Dhënie dhe Lutje për Misionet

Kolumbia u bashkua për misionet përmes Ofertës së Alabastrës dhe Fondit të Ungjillizimit Botëror (FUB)!

Gjatë muajit Tetor 2024, Kisha e Nazaretasit në Kolumbi përjetoi një kohë uniteti të thellë, qëllimi dhe pasioni për misionet globale përmes pjesëmarrjes në Ofertën e Alabastrës. Me zemra bujare dhe një vizion të përqendruar në zgjerimin e Mbretërisë së Perëndisë, kishat lokale u bashkuan me gëzim në këtë shprehje të prekshme dashurie dhe përkushtimi.

E njëjta frymë përkushtimi u vu re edhe gjatë muajit Nëntor, kur distriktet e vendit u bashkuan me entuziazëm për të paraqitur Ofertën e Falënderimeve për Fondin e Ungjillizimit Botëror (FUB). Falë kësaj përpjekjeje të përbashkët, u mbledh një shumë historike: më shumë se 27,000 \$ Amerikanë nga të dyja ofertat misionare, duke shënuar një unitet të paparë në historinë e dhënies për misionet në vend.



Mbikëqyrësit, drejtuesit e Misioneve Ndërkombëtare të Nazaretasit (MNN), pastorët dhe kongregacionet nga zonat më të largëta rurale deri në qytetet më të mëdha iu përgjigjën thirrjes, si një trup i vetëm. Kjo pjesëmarrje masive bashkëpunuese tregoi se kur populli i Zotit mobilizohet në një mendje të përbashkët, ajo që pason është përparimi i misioneve, fuqi transformuese dhe ndikim i rëndësishëm personal dhe komunitar.



Kjo bujari nuk përfaqësoi vetëm një bekim financiar; por gjithashtu shkaktoi një ringjallje të frymëzuar nga Fryma në zemrën e kishës Kolumbiane, ku çdo brez ripohoi angazhimin e vet ndaj Urdhërimit të Madh të Krishtit. Kur përjetohet një unitet i tillë i përqendruar tek Krishti, bashkpunimi në grup rrjedh në mënyrë harmonike dhe efektive, duke e bërë të jashtëzakonshmen të mundshme.



Bekimet vazhduan të dëshmoreshin përmes një lëvizjeje të fuqishme lutjeje në të gjithë vendin. Gjatë Javës Globale të Lutjes, kisha u thirr të ndërmjetësoje për rajonet e botës. Përmes takimeve të përditshme në Zoom, udhëheqës, pastorë dhe anëtarë nga distrikte të ndryshme u bashkuan në ndërmjetësim, duke arritur mesatarisht 120 pjesëmarrës në ditë dhe rreth 800 ndërmjetësues gjatë gjithë javës.

Ne lavdërojmë Perëndinë për rizgjimën e jashtëzakonshëm misionar që po përjeton Kisha e Nazaretasit në Kolumbi!

KALEIDOSKOP PËR FËMIJË



Klikoni [këtu](#) për të hyrë në Kaleidoskopin për Fëmijë, një shtesë mujore në MNN-në Qendrore për të zgjuar dhe ushqyer një frymë misionare tek të gjithë.



Kolumbia

Kolumbia fitoi pavarësinë e saj nga Spanja në 1819, por ka qenë një vend i njohur nga përçarja. Për katër dekada, ajo vuajti nga konflikti i armatosur. Grupet Marksiste guerile, shoqëritë e drogës që kërkonin të kontrollonin sektorët e vendit dhe grupe të tjera paramilitare që luftonin për dominim, detyruan miliona Kolumbianë të largoheshin nga vendi i tyre. Një proces paqeje, që nisi në vitin 2004, ka ndihmuar në sjelljen e stabilitetit dhe çmobilizimin e grupeve të milicisë partizane. Që nga viti 1991, kushtetuta e re e Kolumbisë ka hapur dyert për më shumë larmishmëri fetare, megjithëse 93% e popullsisë përbëhet nga të Krishterë (79% Katolikë Romakë dhe 14% Protestantë). Kisha e Nazaretasit ka qenë e pranishme në Kolumbi që nga viti 1975 dhe ka përjetuar ndikimin e shumë prej atyre viteve përçarëse. Por, Zoti po lëviz përmes Kishës së Nazaretasit, duke sjellë unitet në mënyra jetësore, nëpër breza, për të ndikuar në këtë vend dhe më gjerë me Lajmin e Mirë të Jezusit dhe mesazhin transformues të shenjtërisë biblike.



20,476 Anëtarë



96 Kisha të Organizuara Plotësisht; 17 Kisha të Paorganizuara Ende



140 Shërbëtorë të Liçensuar dhe 47 Shërbëtorë të Shuguruar në 8 Distrikte

Lutje

- Lutuni që Zoti të vazhdojë të konfirmojë dhe forcojë identitetin misionar të Kishës së Nazaretasit në Kolumbi, ndërsa çdo kongregacion përqafton rolin e saj brenda kishës globale.
- Lutuni që drejtuesit distriktual dhe lokalë të MNN-së të frymëzohen me kreativitet, mençuri dhe pasion për të komunikuar dhe marrë pjesë në historinë e gjallë të misioneve.
- Lutuni për drejtuesit kombëtarë të MNN-së, ndërsa ata zhvillojnë strategji për trajnim të efektshëm të drejtuesve të misioneve lokale.



Lavdërime

- Lavdi Zotit për përkushtimin e angazhimit të kishave lokale të Nazaretasit në Kolumbi ndaj Fondit të Ungjillizimit Botëror (FUB), si përgjigje ndaj besnikërisë së Perëndisë dhe thirrjes për një angazhim më të thellë në misione.
- Lavdi Zotit për riaktivizimin e Konventave të Distriktit të MNN-së në disa nga distriktet e Kolumbisë. Ky momentum i ri po forcon bashkësinë, vizionin dhe përkushtimin e vendit ndaj misioneve.



A MUND TË SHËRBESH?

A po ju thërret Perëndia të përfshihenit më shumë në NMI në kishën ose distriktin tuaj lokal? Për më shumë informacion, [klikoni këtu](#).

NMI Central është i disponueshëm në një arkiv PDF të kuruar. Për të lexuar botimet e mëparshme, [klikoni këtu](#).

